

AKT THEMELIMI

Për krijimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar
“KELI ALBANIA - ALUMIN & PVC GROUP” SH.P.K.

Sot, më datën 11/08/2021 **RENATO PAJO** i lindur në Durrës, me datë 15/07/1986 mbajtës i kartës së identitetit me numër I60715097W, banues në Durrës, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar dhe **XHEMAL JIMMY SHAHINI** i lindur në Prishtinë, Kosovë, me datë 14/09/1978 mbajtës i pasaportes me numër 518850225, banues në Houston; Texas, USA, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar vendosi të themelojë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar “**KELI ALBANIA - ALUMIN & PVC GROUP**” SH.P.K. si më poshtë vijon:

Neni 1

Personi fizikë i sipërpërmendur, me vullnetin e saj të lirë dhe të plotë dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar, krijojnë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar (Sh. P. K.) me emërtimin “**KELI ALBANIA - ALUMIN & PVC GROUP**” SH.P.K. Ortaket e shoqërisë janë Z. Renato Pajo dhe Z. Xhemal Jimmy Shahini

Administrator i kësaj shoqërie caktohet Z. Renato Pajo

Shoqëria ka të drejtë të krijojë filiale të saja brenda dhe jashtë vendit në çdo kohë që do të vlerësohet e arsyeshme prej saj dhe me aprovimin e organeve kompetente.

Neni 2

Shoqëria “**KELI ALBANIA - ALUMIN & PVC GROUP**” SH.P.K. gëzon statusin juridik të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “Sh. P. K.”. Veprimtaria e saj do të zhvillohet sipas dispozitave të kësaj kontrate, statutit të saj dhe legjislacionit në fuqi.

Selia e shoqërisë “**KELI ALBANIA - ALUMIN & PVC GROUP**” SH.P.K. është Durrës, sukth i ri, zona kadastrale 3542, nr pas 68/137.

Statuti i shoqërisë i bashkangjitet këtij akti themelimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Shoqëria ka vulën e saj me logon dhe të dhënat të përcaktuara.

Neni 3

Veprimtaria e shoqërisë si person juridik fillon me aprovimin e krijimit të saj nga organet kompetente të shtetit dhe do të vazhdojë për një periudhë kohe të pa caktuar.

Neni 4

Shoqëria do të kryejë aktivitetet me objekt:

X.S R.P

- Punime duralumini dhe plastike
- Ushtrimit të çdo veprimtarie të ligjshme, të lejueshme për formën e shoqërisë, e cila nuk ndalohet me ligj sipas nenit 7 të Ligjit tregtar nr.9901, dt. 14,04,08.

Neni 5

Kapitali i shoqërisë është 100.000 Leke. Kapitali i shoqërisë ndahet në një numër kuotaash në raport me kontributin e dhënë nga çdo ortak në shoqëri ku çdo ortak zoteron një kuota të vetme në shoqëri, kuota këto të shlyera si më poshtë:

Renato Pajo zotërues i një kuote me vlerë të përgjithshme 75.000 leke që përbën 75% të kapitalit të shoqërisë.

Xhemal Jimmy Shahini zotërues i një kuote me vlerë të përgjithshme 25.000 leke që përbën 25% të kapitalit të shoqërisë.

Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme ose të paluajtshme apo të drejta). Ortaku përgjigjet për humbjet e shoqërisë kundrejt të tremeve deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Neni 6

Fitimi neto nga aktiviteti i kësaj shoqërie i përket ortakëve të saj.

Neni 7

Për detyrimet që do të krijohen ndaj personave të tretë gjatë aktivitetit të kësaj shoqërie do të përgjigjet vetë shoqëria deri në kufirin maksimal të kapitalit të saj.

Neni 8

Marrëdhëniet e punës në shoqëri dhe në filialet e saj rregullohen nëpërmjet kontratës së punës.

Neni 9

Dispozita të hollësishme mbi organizimin e kësaj shoqërie përcaktohen në statutin e saj. Themeluesit e kësaj shoqërie, pasi e lexuan me vëmendje këtë akt themelimi dhe e gjetën në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me vullnetin e tyre, e firmosën pa vërejtje.

ORTAKET E SHOQËRISË

Renato Pajo



Xhemal Jimmy Shahini

